



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 132 Prot

Tiranë më, 05/02/2015

V E N D I M

Nr. 02 datë 05.02.2015

Në mbështetje të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

V Ë R E J S E:

Në zbatim të urdhrit nr. 235 datë 18/12/2014, është ushtruar inspektim administrativ pranë kontrolluesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), me objekt;

- Verifikimi i zbatimit të Rekomandimit nr. 50 datë 20/05/2014, të zyrës së Komisionerit, ndaj këtij kontrolluesi.

Kontrolluesi, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nëpërmjet Rekomandimit nr. 50 datë 20/05/2014, të zyrës së Komisionerit, detyrohet që;

- Në zbatim të nenit 18/2, 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, gjatë mbledhjes, përpunimit të të dhënave personale në rrugë manuale dhe elektronike, të bëj informimin e subjekteve të të dhënave personale dhe të publikojë në faqen zyrtare në internet www.iss.gov.al, një rubrikë të veçantë "politikat e privatësisë".
- Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr.19 datë 03/08/2012 "Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi" të Komisionerit, në kontratat dhe marrëveshjet e lidhura me palët e treta, të cilëve u janë deleguar shërbime, kontrolluesi të përfshijë rregulla të qarta mbi të drejtat dhe detyrimet që mbartin palët kontraktuese për garantimin e përdorimit të ligjshëm të sigurt dhe konfidencial të të dhënave personale.
- Në zbatim të neneve 8, 9, 27, 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, kontrolluesi, në marrëveshjen e lidhur ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, "Mbi mbrojtjen

shoqërore” të përfshijë parimet e përgjithshme të mbrojtjes së të dhënave personale, kushtet dhe kriteret e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale.

- Në zbatim të neneve 6, 18, 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, udhëzimit të veçantë nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, kontrolluesi, të hartojë rregullore të shkruar, për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, aksesin e autorizuar, nëpërmjet përdorimit të video-survejjimit (regjistrim me kamera). Të bëhet informimi i subjekteve të të dhënave personale, duke u vendosur tabelat informuese për këtë lloj përpunimi sipas standardit të miratuar nga Komisioneri.

Sipas rekomandimit kontrolluesi, duhet të realizojë këto detyrime brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni për Rekomandimin si dhe të njoftojë me shkrim pranë Komisionerit, për zbatimin e tyre.

Gjatë inspektimit administrativ u konstatua se, kontrolluesi, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, nuk ka përbushur plotësisht detyrat e lëna në Rekomandimin nr. 50 datë 20/05/2014, të zyrës së Komisionerit. Nuk ka hartuar rregullore të veçantë, për mbledhjen, përpunimin e të dhënave personale, nëpërmjet video survejimit me kamera CCTV, si dhe nuk ka bërë informimin e subjekteve të të dhënave personale, nëpërmjet vendosjes së tabelave informuese, për këtë lloj përpunimi të dhënash personale.

Kjo detyrë e përcaktuar, në Rekomandimin nr.50 datë 20/05/2014, të zyrës së Komisionerit, lidhet me zbatimin e nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, udhëzimit nr.3 datë 05/03/2010 të Komisionerit “Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, nga kontrolluesi Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se kontrolluesi ose përpunuesi, merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera.

Mungesa e rregullave dhe e hartimit të rregullores së veçantë, në të cilën të jenë shprehur përcaktimet e nenit 27, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit “Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, tregojnë për mungesën e masave të sigurisë dhe shkallës së ulët të konfidencialitetit që ka kontrolluesi në procesin e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale, nëpërmjet përdorimit të sistemit të video survejimit me kamera CCTV.

Gjithashtu pjesë e hartimit të rregullave për këtë lloj përpunimi të dhënash personale, është dhe informimi i subjekteve të të dhënave personale, nëpërmjet vendosjes së tabelave informuese, në ambientet e kontrolluesit që monitorohen me kamera vëzhgimi CCTV. Informimi i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave nëpërmjet monitorimit me kamera CCTV, është një detyrim i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale.

Në zbatim të neneve 93-96 të ligjit 8485 datë 12/03/1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në datën 29/01/2015 u zhvillua seanca dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit, lidhur me konstatimet e grupit të inspektimit administrativ.

Në seancën e zhvilluar përfaqësuesit e kontrolluesit parashtruan pretendimet e tyre për mosplotësimin e detyrës së lënë në Rekomandimin nr.50 prot, datë 20/05/2014, të zyrës së Komisionerit, si dhe paraqitën në cilësinë e provës “Rregullore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, miratuar në datën 21/01/2015 nga kontrolluesi, Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke vlerësuar konstatimet e bëra dhe qëndrimin e kontrolluesit, mbi zbatimin e detyrimeve të Rekomandimit nr. 50 datë 20/05/2014, konkludon se;

Pretendimi i ngritur nga kontrolluesi në seancë dëgjimore nuk përbën shkak që të justifikojë mosplotësimin e detyrimit nga ana e tij. Gjithashtu, kontrolluesi ka patur të gjithë kohën e nevojshme për respektimin e detyrimit të rekomandimit, i cili mban datën 20/05/2014.

Prova e paraqitur nga kontrolluesi në seancë dëgjimore “Rregullore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, miratuar në datën 21/01/2015, nuk presupozon të përmbushur Rekomandimin, pasi përmbajtja e saj nuk reflekton detyrën e lënë për zbatim në rekomandim. Është detyrim i kontrolluesit që të marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e parashikimeve të ligjit.

Mospërmbushja pjesërisht e Rekomandimit nr.50 datë 20/05/2014 të zyrës së Komisionerit, e ngarkon kontrolluesin Instituti i Sigurimeve Shoqërore me përgjegjësi administrative, sipas nenit 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

- Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, bazuar në nenin 39, pika 1/dh, të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 150 000 lekë.

Gjithashtu, në pikën 2 të nenit 39 është parashikuar se “Personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.”

Për zgjedhjen e masës së gjobës Komisioneri ka parasysh shkallën e njohjes së kontrolluesit me detyrimet që rrjedhin për zbatimin e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, mospërmbushjen në kohë të detyrimit që mbart Rekomandimi i Komisionerit dhe masat reaguese të kontrolluesit për zbatimin e Rekomandimit.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 27, 29, 30/2, 32, 39/1/dh, 40 e 41, të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe 107-109 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit Instituti i Sigurimeve Shoqërore me gjohë në vlerën 40 000 (dyzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.
2. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.
4. Ky vendim u shpall sot më 05/02/2015.

